



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23.07.2024

Nr: 120

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE BALLI KOMBËTAR PËR
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR
KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Sot më datë 23.07.2024, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 2073 Prot., datë 20.07.2024, me:

Kërkues: “Partia Balli Kombëtar”, me kryetar z. Adriatik Alimadhi.

Objekti: Regjistrimi i partisë politike “Partia Balli Kombëtar” (PBK), si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 244, datë 5.7.2024, ka caktuar datën 4 Gusht 2024, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë.

“Partia Balli Kombëtar”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Adriatik Alimadhi, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 Gusht 2024.

Data: 23.07.2024 Nr: 120
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Balli Kombëtar” për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024”.

Nga “Partia Balli Kombëtar” është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 18.07.2024, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Balli Kombëtar”, me iniciale “PBK”, me kryetar z. Adriatik Alimadhi, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Balli Kombëtar” me shkronja nistore “PBK”, me adresë Rruga e Kavajës, pranë shtëpisë Botuese “Naim Frashëri”, kati 3, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Adriatik Alimadhi, me adresë Rruga “Myslym Keta”, objekti ish-shkolla Komunale, kati 1, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është z. Kujtim Lamaj, me adresë Rruga e Kavajës, pranë shtëpisë Botuese “Naim Frashëri”, kati 3, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Kujtim Lamaj, me adresë Rruga e Kavajës, pranë shtëpisë Botuese “Naim Frashëri”, kati 3, Tiranë
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Balli Kombëtar”, respekton afatin kohor të parashikuar në vendimin nr. 3 datë 17.07.2024, të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024”.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga “Partia Balli Kombëtar”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92 /2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe vendimit nr. 3 datë 17.07.2024, të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024”.

VENDOSA:

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Balli Kombëtar”, me kryetar z. Adriatik Alimadhi, me shkronjat nistore “PBK”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orë nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI